

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit K.P., për shkak të veprës penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së dhe veprën penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 i Ligjit për Pastrimin e Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit Ligji nr.05/L-096, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.642/15 të datës 28.06.2017 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PKR.nr.486/2017 të datës 20.11.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 15.05.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me miratimin e pjesërishëm të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit K.P., anulohet pjesërisht aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.642/15 të datës 28.06.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.486/2017 të datës 20.11.2017, vetëm përkitazi me veprën penale pastrimi i parasë dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, kurse pjesa tjetër e aktgjyqimit ndryshohet vetëm përkitazi me dënimin e shqiptuar, ashtu që për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, e merr si të vërtetuar kurse për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, po ashtu e merr si të vërtetuar, ashtu që i shqipton dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 4 (katër) muaj.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.642/15 të datës 28.06.2017, të dënuarin K.P., e ka shpallur fajtor për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së duke i shqiptuar dënim burgimi me kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim burgimi me kohëzgjatje prej 2 (dy) vite si dhe për veprën penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 i Ligjit për Pastrimin e Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Ligji nr.05/L-096) dhe i shqiptuar dënim burgimi me kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 5000 (pesëmijë) €, ashtu që i ka shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 5000 (pesëmijë) €, kurse është liruar nga akuza për veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Të dënuarit i është shqiptuar dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike ose në shërbime publike si dhe ushtrimi i profesionit të avokatit në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, duke filluar nga dita e përfundimit të ekzekutimit të dënimit me burgim. I është konfiskuar pasuria si rezultat /përfitim nga kryerja e veprës penale dhe atë: banesë në Klinë rr. "Dëshmorët e Kombit", banesa nr.6, Hyrja 2, Kati I, Blloku P+3 në sipërfaqe prej 36 m<sup>2</sup> e blerë sipas kontratës së datës 17.04.2003 e vërtetuar në gjykatë në numrin V.nr.629/2003, shitës P.Z. ndërsa blerës K.P. në çmim të përgjithshëm prej 12.000 €, banesë në Prishtinë Lagja Ulpiana, objekti E-30, Lamela I, banesa nr.4 kat përdhese, në sipërfaqe prej 97.30 m<sup>2</sup>, e blerë sipas kontratës së V.nr.9859/2007 e datës 09.11.2007, e lidhur mes të A.J. dhe L.P. si blerës i banesës në vlerë prej 125.000 €, patundshmëri në të cilën është e ndërtuar një shtëpi në Ulqin të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 308 m<sup>2</sup>, parcela me numrin 108 Zona Kadastrale në Ulqin, patundshmërinë e blerë nën kontratën me numër 3852/2006 e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ulqin, lidhur me datë 08.09.2006, ndërmjet K.P. si blerës dhe B.R.P. si shitës e cila paluajtshmëri për momentin është transferuar në emër të mikut të K.P. I. G. me qëndrim në Australi, patundshmëri – livadh në Ulqin të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 171 m<sup>2</sup>, parcela me numrin 107 Zona Kadastrale në Ulqin, patundshërinë e blerë nën kontratën me numër 3191/2006 e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ulqin lidhur me datë 07.08.2006, ndërmjet K.P. si blerës dhe B.R.P. si shitës e cila paluajtshmëri për momentin figuron në emër të babait të K.P.-Z.P. ,shtëpia prej dy kate e cila gjendet në rrugën "Mehdi Morina" në Klinë në

sipërfaqe prej 209 m<sup>2</sup> evidentuar në numrin e parcelës 508/1 dhe 508/5 Komuna Kadastrale Klinë si dhe tokë bujqësore me sipërfaqe prej 1182 m<sup>2</sup> e regjistruar në certifikatën e pronës UL-710006024-00916 e cila tani është në emër të T.P. vëllait të K.P., lokal afarist i cili gjendet në Klinë rr. "Dëshmorët e Kombit", Lamela A, banesa nr.1, kati përdhese, në sipërfaqe prej 39.86 m<sup>2</sup> e blerë sipas kontratës e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë, me numrin V.nr.1771/2005 e datës 01.11.2005 e lidhur mes të K.P. si blerës dhe A.Gj. si shitës e cila tani është në emër të T.P. vëllait të K.P., automjeti "Audi A6" me targa të regjistrimit 03-310-AI, i blerë nga K.P. i cili gjendet në emër të mikut të tij K. G., dhe mjete financiare nga shitja e dy lokaleve afariste paraprakisht të blera nga K.P. në vlerë prej 35.000 €, për njërin lokal dhe 28.000 €, për lokalin tjetër. Në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që ta paguajë shumën prej 150€, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, kurse të dëmtuarit sipas aneksit të aktgjykimit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PKR.nr.486/2017 të datës 20.11.2017, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit K.P., av. T.Rr., duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.642/15 të datës 28.06.2017, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që të dënuarit K.P., i ka vërtetuar dënimet për secilën veprë penale të shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë, por i ka shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) €, i është kthyer në posedim shtëpia prej dy kate e cila gjendet në rrugën "... " në K. në sipërfaqe prej 209 m<sup>2</sup> evidentuar në numrin e parcelës 508/1 dhe 508/5 Komuna Kadastrale K., si dhe tokë bujqësore me sipërfaqe prej 1182 m<sup>2</sup> e regjistruar në certifikatën e pronës UL-710006024-00916 e cila tani është në emër të T.P. vëllait të K.P.. Ankesa e palës së dëmtuar është hudhur poshtë si e palejuar, kurse aktgjykimi i ankimuar në pjesët tjera ka mbetur i paprekur.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati T.Rr. nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale me

ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën dhe të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara ashtu që të dënuarin ta lirojë nga akuza dhe t'i kthejë pasurinë e konfiskuar apo të anulojë, aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë, në rigjykim.

### **Mendimi i Prokurorit të Shtetit**

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.nr.17/2018, të datës 06.02.2018, duke propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit, theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje të ligjit penal, pasi që në veprimet e të dënuarit nuk janë manifestuar elementet e veprave penale për të cilat është shpallur fajtor dhe atë fillimisht përkitazi me veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së. Nuk është vërtetuar se janë plotësuar elementet qenësore të kësaj veprë penale e cila kryhet vetëm me dashje direkte, ndërsa qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër ose shkaktimi i dëmit të personit tjetër, paraqet formën speciale të dashjes, për më tepër kjo veprë penale nuk kryhet me dashje eventuale e as nga pakujdesia. Gjykata e shkallës së parë me asnjë provë të vetme nuk ka vërtetuar faktin se i dënuari ka nxjerr aktgjykimin C.nr.54/2000 edhe pse nuk është kontestues fakti se i dënuari ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë, mirëpo kjo lëndë është ende e papërfunduar e po ashtu janë palë të tjera dhe kontest tjetër, ashtu që nuk qëndron fakti siç është arsyetuar nga gjykata e shkallës së parë se lënda në fjalë ka të bëjë me kompensimin e dëmit ndaj personave Rr.dhe Q.G. Kurse lënda tjetër C.nr.282/2005, nuk ka ekzistuar fare në gjykatën e shkallës së parë, përkatësisht është aktgjykim tërësisht i falsifikuar dhe nuk është vërtetuar se i dënuari e ka bërë këtë falsifikim, pasi edhe ka mohuar se ka marrë pjesë në procedurë gjyqësore në këtë rast.

Gjithashtu edhe lidhur me veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal në dëm të të dënuarit, pasi që kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje direkte dhe për të ekzistuar kjo veprë penale

kërkohej që kryerësi të ndërmer veprimin në kuadër të detyrave apo autorizimeve të tij zyrtare e që në rastin konkret i dënuari ka pranuar se ka plotësuar 19 formular blanko të autorizimeve e që këtë e ka bërë për shkak të kërkesës së të ndjerit H.H., për kompensim simbolik, por ka mohuar se ka vulosur dhe nënshkruar këto autorizime. Gjykata e shkallës së parë me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se autorizimet janë nënshkruar nga i dënuari, por edhe sikur të bënte falsifikimin e pretenduar, megjithatë nuk ka kryer këtë veprë penale pasi që në cilësinë e gjyqtarit, veprimi i kryer nuk hyn në veprimtarinë e detyrave të tij zyrtare.

Sa i përket veprës penale të pastrimit të parasë, në kërkesë pretendohet se kjo veprë penale nuk ka qenë e inkriminuar fare në kohën kur pretendohet se i dënuari ka kryer këtë veprë penale, meqë Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2 që ka inkriminuar këtë veprë penale ka hyrë në fuqi me datë 01 mars 2004 kurse me ligjet tjera nuk ka qenë e përcaktuar kjo veprë penale, kurse referenca e gjykatës së shkallës së dytë në Rregulloren 2002/2 nuk e rregullon veprën penale në fjalë por ka të bëjë me dëshmitarët bashkëpunues. Edhe nën supozimin se në kohën e kryerjes ka ekzistuar inkriminimi i kësaj veprë penale, megjithatë kjo nuk është kryer nga i dënuari pasi që me paratë e përfituara nga vepra penale ka blerë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme siç gabimisht ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë.

Më tutje në kërkesë, pretendohet se për ekzistimin e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe kundërthënës me brendinë e tij dhe arsyetimin e tij, e po ashtu nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare, kurse arsyet e paraqitura janë plotësisht të paqarta dhe kundërthënëse, përkatësisht ka kundërthënie mes të arsyetimit dhe përmbajtjes së provave. Po ashtu përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit është në kundërshtim me gjendjen faktike pasi që nuk është vërtetuar me asnjë provë se aktgjykimin e ka nxjerr i dënuari, meqë aktgjykimi me emrat e familjarëve G. nuk është evidentuar në regjistrin e lëndëve të Gjykatës Komunale në Klinë që nënkuptohet se aktgjykimi është tërësisht i falsifikuar e që gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar personin që e ka kryer falsifikimin e këtij aktgjykimi. Por edhe sikur i dënuari të kishte falsifikuar aktgjykimin, megjithatë nuk janë kryer veprat penale në fjalë, por vepra penale e mashtrimit pasi që falsifikimi është bërë me qëllim të mashtrimit të KS Kosova në likuidim që të veproj në dëm të pasurisë së saj. Pretendohet po ashtu edhe se përshkrimi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë edhe përkitazi me kohën e kryerjes së veprës

penale, pasi që nuk është përcaktuar saktë koha e kryerjes së për secilin veprim të të dënuarit por vetëm ka përcaktuar periudhën kohore kur janë kryer falsifikimet e autorizimeve përkatësisht ndërmjet datave 18.11.2002- 18.12.2007 dhe gjykata e shkallës së parë është dashur që të vërtetoj secilin veprim inkriminues, meqë kjo ndërlidhet me afatin e parashkrimit të ndjekjes penale.

Mbrojtësi i të dënuarit po ashtu pretendon se janë shkelur edhe dispozitat përkitazi me konfiskimin e pasurisë që është shqiptuar përmes këtij aktgjykimi pasi që nuk është vlerësuar ekspertiza financiare përkitazi me vlerën e përfitimit nga vepra penale dhe vlera e sendeve të konfiskuara, përkatësisht duhet të vërtetohet proporcionaliteti i vlerës mes përfitimit të dobisë pasurore dhe sendeve të konfiskuara e po ashtu shkelja ekziston edhe për faktin se disa nga sendet e konfiskuara nuk janë pronë e të dënuarit dhe me këtë rast ka qenë dashur që personat pasuria e të cilëve është konfiskuar që të dëgjohen përkitazi me konfiskimin e pronës e cila është konfiskuar.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

*kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar.*

Nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitura në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë në shkelje të ligjit penal përkitazi me veprat penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, meqë sipas arsytimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsytetime të qarta përkitazi me këto dy vepra penale. Gjykata e shkallës së parë në arsytimin e saj drejtë ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar elementet e veprës penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore meqë është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se i dënuari nga viti 2000 ka pasur cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Klinë dhe po ashtu ka nxjerr vendim të kundërligjshëm gjyqësor, përkatësisht aktgjykimin C.nr.54/2000 përkitazi me kompensimin e dëmit për aksidentin e ndodhur në vitin 1996 kurse të dëmtuar kanë qenë Rr. dhe Q.G., ashtu që i dënuari falsifikon autorizimin kinse Rr. dhe Q.G. kanë autorizuar avokatin L.P. për t'i

përfaqësuar ashtu që pastaj arrihet marrëveshja gjyqësore për kompensim në shumë prej 56.000,00 € dhe 53.000, 00 € i merr i dënuari kurse pjesa tjetër prej 3000,00 € i jepet nga ana e të dënuarit L. P., si avokat. Po ashtu edhe për rastin e aktgjykimit C.nr.282/2005, kompensim i dëmit për aksidentin e komunikacionit të ndodhur në vitin 1990, ku ka humbur jetën Sh.G., vëllai i të ndjerit B.G., ka parashtruar kërkesë për kompensimin e dëmit përmes avokatit B. G., dhe pastaj është kompensuar në shumë prej 17.00,00 €, nga të cilat shumën prej 11.900,00 € e merr familja e të dëmtuarit, kurse pjesën tjetër e merr avokati i autorizuar. Mirëpo i dënuari pastaj harton një autorizim të ri për avokatin Z.M., të falsifikuar në emër të dhjetë anëtarëve të familjes G. dhe pastaj në shqyrtim gjyqësor arrijnë marrëveshje jashtëgjyqësore mes të autorizuarit dhe Kompanisë së Sigurimit në likuidim “Kosova” në shumë prej 61.536,47 €, ashtu që shumën prej 17.000,00€, ia jep av.B. G., kurse pjesën tjetër të shumës së kompensimit e merr i dënuari.

Po ashtu, me të drejtë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar elementet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, pasi që i dënuari 19 autorizime blanko përkatësisht të paplotësuara, ashtu që i ka plotësuar me emrat e palëve të autorizuar në emër të personit të autorizuar, faktet e aksidentit dhe pastaj i ka vulosur me vulë të Gjykatës Komunale në Klinë e duke i regjistruar me numër të rastit e që nuk korrespondojnë me regjistrin e gjykatës përkatësisht vërtetohen se janë tërësisht të falsifikuara.

Pretendimi i paraqitur në kërkesë, se i dënuari nuk ka kryer veprat penale në fjalë nuk është i bazuar. Sipas arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk qëndrojnë argumentet e mbrojtjes pasi që është vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur elementet objektive dhe subjektive të figurës së veprave penale në fjalë, ashtu që me të drejtë i dënuari është gjetur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi për veprat penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar e të cilat konkludime i pranon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Më tutje në kërkesë pretendohet për ekzistimin e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe kundërtëhënës me brendinë e tij dhe arsyetimin e tij e po ashtu nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare, kurse arsyet e paraqitura janë plotësisht të paqarta dhe

kundërthënëse, përkatësisht ka kundërthënie mes të arsytimit dhe përmbajtjes së provave të administruara. Ky pretendim nuk u aprovua sepse u gjet se është i pa-precizuar dhe i pa-konkretizuar, ndërsa kjo gjykatë nuk konstatoi ekzistimin e shkeljes së këtillë.

Sa i përket pretendimeve, përkitazi me veprën penale pastrim i parasë, gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë veprë penale ka zbatuar ligjin i cili nuk ka inkrimuar një pjesë të periudhës kohore ku pretendohet se i dënuari ka kryer këtë veprë penale. Në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë konstatohet se i dënuari veprën penale pastrimi i parasë e ka kryer gjatë periudhës kohore 2002-2008 dhe me këtë rast është aplikuar Ligji për Pastrimin e Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (nr.05/L-096) i cili ka hyrë në fuqi me datën 13.06.2016, i cili ligj sipas gjykatës së shkallës së parë është aplikuar për shkak të uniformitetit. Megjithatë gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e ligjit në fjalë pasi që me rastin e aplikimit të ligjit më të favorshëm në vend të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, ka aplikuar Ligjin nr.05/L-096, mirëpo gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur parasysh faktin se Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2, ka hyrë në fuqi me datën 01 mars 2004, ashtu që periudha e përfshirë në dispozitivin e aktgjykimit prej dy vite nuk ka qenë e inkrimuar si veprë penale, andaj edhe për këtë periudhë nuk mund të aplikohet as Ligji më i favorshëm përkatësisht Ligji për Pastrimin e Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (nr.05/L-096) siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë.

Duke vepruar kështu, aktgjykimi i shkallës së parë, përmban shkelje të ligjit penal nga neni 385 pa.1 nënpar.1.4 të KPPK-së dhe për këtë arsye u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen pjesërisht vetëm për veprën penale pastrimi i parasë dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të aplikoj drejt ligjin duke pasur parasysh periudhën kohore të veprimeve që pretendohet se i ka kryer i dënuari. Me rastin e aplikimit të ligjit penal, gjykata e shkallës së parë duhet të aplikoj ligjin i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, kurse me këtë rast duhet të zbatoj ligjin më të favorshëm duke aplikuar dispozitën e nenit 3 par.2 të KPRK-së e jo parimin e uniformitetit siç ka vepruar gjykata e shkallës së parë në këtë aktgjykim.



Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishe e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.26/2018, më datë 15.05.2018

Bashkëpunëtori profesional,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Nesrin Lushta